

TABELA E REZULTATEVE TE VENDEVE QE ASPIROJNE HEQJEN E VIZAVE SHENGEN

Iniciativa për Stabilitet European (ESI – European Stability Initiative), një institut politikash që merret me analiza komplekse të çështjeve të ndryshme, ndër të tjera ato që përfshijnë rajonin e Ballkanit me qendër në Bruksel, Berlin e Stamboll, ka publikuar me 22 Maj 2009 një dokument krahasues vlerësimi me standardet që kanë plotësuar vendet e Ballkanit Perëndimor për të përfituar nga regjimi i liberalizimit të vizave. Dokumenti i publikuar është bazuar tek vizitat e ekspertëve të misionit vlerësues të situatës dhe të Vlerësimit të Komisionit European të implementimit të Udhërrëfyesit mbi Liberalizimin e Vizave nga ana e shteteve të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi i Komisionit European do të diskutohet nga Vendet Anëtare të BE me 25 Maj 2009. Në bazë të këtyre vlerësimeve, Bashkimi European do të vendosë se cili prej vendeve do të përfitojë lëvizjen e lirë për qytetarët e vet duke filluar nga viti 2010.

Komisioni European në vlerësimin e tij për përmbushjen ose jo të standardeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka përdorur 6 shprehje të ndryshme të cilat variojnë nga “plotëson standardet” deri tek “nuk plotëson standardet”. Sipas metodologjisë së vlerësimit, nota 1 përkon me “përmbushjen e standardeve”, nota 2 përkon me “përmbushjen e shumicës së standardeve” dhe nota 3 përkon me “mospërmbushjen e standardeve”.

Shqipëria renditet e fundit së bashku me Bosnje Hercegovinën, duke marrë notën 3 në të katër Blloqet e Udhërrëfyesit, ndërkohë që Maqedonia ka marrë notën 1, duke qenë se i ka plotësuar të gjitha standardet. Mali i Zi dhe Serbia kanë marrë notën mesatare 1,75 dhe presin vendimin e BE-së në lidhje me heqjen e regjimit të vizave Shengen për qytetarët e tyre. Shqipëria ka marrë vlerësimin më negativ në të katër Blloqet e kritereve të Udhërrëfyesit, ndërkohë që Maqedonia ka marrë vlerësimin maksimal.

Raportet e Misioneve të Vëzhgimit, duke u kombinuar edhe me informacionin që është dërguar nga vetë qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e Raporteve më të fundit të Vlerësimit të Komisionit për secilin vend. Sipas Alexandra Stiglmayer analiste pranë Iniciatës për Stabilitet European: “Javën tjetër, më 25 maj 2009, Komisioni European do të diskutojë mbi këto rezultate me zyrtarët e vendeve anëtare, dhe më pas do të sugjerojë heqjen e regjimit të vizave Shengen për Maqedoninë, ndërkohë që për momentin do ta refuzojë këtë për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Mali i Zi dhe Serbia do të duhet të tregojnë se progresi impresiv i kohëve të fundit realizuar nga qeveritë e këtyre vendeve do të vazhdojë edhe më tej, në mënyrë që të përfitojnë regjim pa viza me BE-në. Në rast të një vendimi negativ për to, një opsion i tretë vetëm për këto dy vende (Mali i Zi dhe Serbia) është një Vlerësim i ri final nga ana e Komisionit European rreth fundit të muajit Korrik 2009”.

Tabela e Rezultateve – Kushtet drejt Listës Pozitive Shengen

22 Maj 2009

Bazuar në misionin e ekspertëve të BE dhe Vlerësimet e brendshme të Komisionit Europian mbi zbatimin e Udhërrëfyesit drejt një regjimi pa viza në vendet e Ballkanit Perëndimor (18 Maj 2009)

| | | |
|--------------------|--------------------------------------|------------|
| 1. Maqedonia | <i>i plotëson kriteret</i> | nota: 1 |
| 2. Mali i Zi | <i>plotëson shumicën e kriterëve</i> | nota: 1,75 |
| Serbia | <i>plotëson shumicën e kriterëve</i> | nota: 1,75 |
| 3. Shqipëria | nuk plotëson kriteret | nota: 3 |
| Bosnje-Hercegovina | nuk plotëson kriteret | nota: 3 |
| 4. Kosova | pa vlerësim | nota: - |

Shpjegim: Në Vlerësimet e tij, Komisioni Europian ka përdorur këto fraza për të shpjeguar progresin e vendeve specifike në katër fusha kryesore, duke filluar nga “i plotëson kriteret” deri tek “ende nuk i plotëson krejtësisht kriteret”. Çdo fraze i është bashkangjitur një notë specifike:

1 = “i plotëson kriteret” dhe “përgjithësisht i plotëson kriteret”

2 = “plotëson një numër të konsiderueshëm të kriterëve” dhe “plotëson pjesën më të madhe të kriterëve”

3 = “në rrugën e duhur, por...” dhe “ende nuk i plotëson kriteret”

| | Shqipëria | Bosnja | Maqedonia | Mali i Zi | Serbia |
|---|-----------|----------|-----------|-----------|----------|
| Siguria e dokumentave | 3 | 3 | 1 | 1 | 1 |
| Migracioni ilegal dhe ripranimi | 3 | 3 | 1 | 2 | 2 |
| Redndi dhe siguria publike | 3 | 3 | 1 | 2 | 2 |
| Marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore | 3 | 3 | 1 | 2 | 2 |